

PSE PËRDORIMI I PELERINËS SË PLOMBIT NUK ËSHTË MË I RËNDOMTË?

Çfarë është?

Mbrojtja e pacientit do të thotë të vendosësh një mbulesë mbrojtëse, zakonisht prej plumbi, mbi pjesë të trupit tënd ose të fëmijës tënd që nuk po ekzaminohen gjatë radiografisë ose skanimit CT.

Vitet e fundit, njohuritë tona për përdorimin e mbrojtjes kanë ndryshuar.

Çfarë ka ndryshuar?

- 1 Pajisjet e radiologjisë janë përmirësuar dhe tani përdorin shumë më pak rrezatim..
- 2 Nëse pelerina vendoset gabim ose lëviz, mund të mbulojë pjesë të rëndësishme të imazhit dhe të duhet përsëritja e ekzaminimit.
- 3 Pelerinat gjithashtu mund të prishin cilësimet automatike të pajisjes, duke rritur dozën e rrezatimit dhe duke ulur cilësinë e imazhit, gjë që mund të kërkojë një ekzaminim tjetër.
- 4 Mbulimi i pjesëve të trupit që nuk ekzaminohen nuk ul sasinë e vogël të rrezatimit që tashmë ka kaluar në trup.
- 5 Pelerinat mund të shkaktojnë edhe probleme higjienike.

Për këto arsye, përdorimi i përditshëm i pelerinës së plumbit nuk rekomandohet më.

Stafi mjekësor përdor shumë metoda të tjera për të ulur rrezatimin për ty ose fëmijën tënd

Po sikur të jem shtatzënë?

Edhe gjatë shtatzënisë, ndonjëherë nevojiten ekzaminime me rreze X ose CT. Ne do të marrim masa shtesë sigurie dhe do të vendosim nëse pelerina është e nevojshme. Është shumë e rëndësishme të thuash para ekzaminimit nëse je shtatzënë ose dyshon se je, që të mund të marrim masa të përshtatshme për të mbrojtur fëmijën e palindur ose për të shtyrë ekzaminimin.



Pse e vesh pelerinën kur fëmija im po ekzaminohet?

Ekzaminimi shërben për të diagnostikuar dhe trajtuar fëmijën tënd. Edhe pse rrezatimi në dhomë është shumë i ulët, personat që qëndrojnë aty duhet të veshin pelerinë mbrojtëse.

Pse stafi ende mban pelerinë?

Stafi ekspozohet shpesh ndaj rrezatimit dhe duhet të ulë dozën e rrezatimit sa më shumë që të jetë e mundur. Kjo është arsyeja pse ata i mbajnë këto pajisje mbrojtëse.

A ka përjashtime?

Po. Nëse kërkon ose në raste të veçanta, mund të përdoren pelerina për të mbuluar pjesë të trupit që nuk po ekzaminohen.

Ke pyetje të tjera?

Pyet stafin mjekësor për masat që merren për të të mbrojtur ty dhe fëmijën tënd dhe për të ulur rrezatimin.



Më shumë informacion mund të gesh në linkun e dhënë.

